

UDHËZIM
Nr. 5, datë 16.7.2025

**PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NGA AUTORITETET
KOMPETENTE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 66, germës “d”, të pikës 1, të nenit 82, pikës 1, të nenit 85 dhe pikës 2, të nenit 97, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim quajtur, “Ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”),

UDHËZON:

Neni 1
Objekti

Ky udhëzim ka për objekt përcaktimin e rregullave për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale nga ana e autoriteteve kompetente¹, të cilët gjatë veprimtarisë përpunojnë të dhëna personale të administruara në mënyrë manuale dhe elektronike, në zbatim të pjesës III, të ligjit.

Neni 2
Qëllimi

Ky akt nënligjor udhëzon autoritetet kompetente, për mënyrën e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale që grumbullohen me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë publike, mbrojtjes ose sigurisë kombëtare.

Neni 3
Përkufizime

1. “*Anonimizim*” është procesi i përdorimit të një grupi teknikash, sipas të cilave të dhënat personale përpunohen në mënyrë të atillë që e bëjnë të pamundur që një person fizik apo juridik t’ia atribuojë këto të dhëna një personi fizik të identifikuar apo të identifikueshëm.

2. “*Nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave*” është një ekspert i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, që ka rol këshillues dhe ndërgjegjësues në raport me kontrolluesin ose përpunuesin në zbatimin e ligjit. Nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave monitorojnë përputhshmërinë e brendshme, informojnë dhe këshillojnë mbi detyrimet që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave dhe veprojnë si një pikë kontakti për subjektet e të dhënave dhe Komisionerin. Në thelb, ata sigurohen që kontrolluesi/përpunuesi t’i përpunojë të dhënat personale në mënyrë të ligjshme.

3. “*Profilizimi i të dhënave*” është çdo formë e përpunimit të automatizuar të të dhënave personale, që konsiston në përdorimin e të dhënave për të vlerësuar aspekte të caktuara që lidhen me një person fizik, veçanërisht për të analizuar ose për të parashikuar aspekte lidhur me performancën në punë, gjendjen ekonomike, shëndetin, preferencat personale, interesat,

¹ Në pikën 1, të nenit 5 të ligjit parashikohet se: “1. “*Autoritet kompetent*” është gjykata, prokuroria dhe çdo organ publik, që ka në kompetencë parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, përfshirë mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë publike, mbrojtjes ose sigurisë kombëtare ose çdo institucion tjetër, të cilit i është dhënë me ligj e drejta për të ushtruar funksione, detyra ose kompetenca publike, në bazë të legjislacionit në fuqi për një ose disa prej këtyre qëllimeve”.

besueshmërinë, sjelljen, vendndodhjen ose lëvizjet e tij. Kjo përfshin përdorimin e të dhënave për të marrë vendime që ndikojnë ndjeshëm te jeta private e individit.

4. Termat e tjerë të përdorur në këtë udhëzim, kanë të njëjtin kuptim me ato të nenit 5, të ligjit.

Neni 4

Dispozita të përgjithshme

1. Autoritetet kompetente kryejnë përpunimin e të dhënave me mjete të automatizuara ose jo, për garantimin e sigurisë publike ose kombëtare dhe për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale, të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale².

2. Për të dhënat e përpunuara për këto qëllime, autoritetet kompetente duhet në çdo rast të garantojnë zbatimin e parimeve³ të ligjshmërisë, përpunimit në përputhje me qëllimin, minimizimit të të dhënave, saktësisë së të dhënave, kufizimit të ruajtjes në kohë, integritetit dhe konfidencialitetit, si dhe përgjegjshmërisë.

3. Autoritetet kompetente caktojnë një nëpunës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 5

Fusha e veprimtarisë

1. Ky udhëzim zbatohet për të gjitha përpunimet e të dhënave personale, që kryhen nga ana e Autoriteteve kompetente, të cilat përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 47 të ligjit.

2. Autoritet kompetent, do të konsiderohet edhe çdo institucion tjetër, të cilit i është dhënë me ligj e drejta për të ushtruar funksione, detyra ose kompetenca publike, në bazë të legjislacionit në fuqi⁴.

3. Autoritetet kompetente do të zbatojnë parashikimet e këtij udhëzimi vetëm për sa u përket të dhënave personale që përpunohen për këto qëllime specifike. Për sa u përket të dhënave të tjera personale që përpunohen si të dhëna rreth stafit ose për qëllime që nuk lidhen drejtpërdrejt me ato të përcaktuara në pikën 1, të nenit 5 të ligjit, zbatohen si për çdo Kontrollues parashikimet e përgjithshme të pjesës I dhe II të ligjit.

Neni 6

Kategoritë e të dhënave personale

1. Të dhënat personale që përpunohen nga autoritetet kompetente, kategorizohen si më poshtë vijon:

a) të dhëna të përgjithshme identifikuese;

b) të dhëna sensitive, përfshirë përkatësinë etnike ose racore, mendimet politike, besimin fetar, anëtarësinë në sindikata, të dhëna biometrike dhe gjenetike, të dhëna për shëndetin, jetën ose orientimin seksual;

c) të dhëna që lidhen me dënime penale, veprat penale dhe masat e sigurimit në lidhje me to etj.

² Në mbështetje të pikës 1, të nenit 3 dhe nenit 47 të ligjit.

³ Parashikuar në nenin 6 dhe 48 të ligjit.

⁴ Në interpretim të pikës 1, të nenit 5 të ligjit do të konsiderohen si autoritete kompetente edhe organe të tjera të cilat nuk kanë këtë si objekt primar të veprimtarisë, por kryejnë edhe përpunim të të dhënave për një ose disa prej këtyre qëllimeve (*përfshihen në përkufizim edhe autoritete vendore, kur ndjekin raste që mund të konsiderohen si vepra penale dhe jobiten*).

2. Në rastet e përpunimit të të dhënave personale të bazuara në vlerësime personale duhet të mbahet një regjistër i veçantë, duke specifikuar edhe arsyet apo rrethanat për këtë vlerësim.

Neni 7

Ndërveprimi i sistemeve

1. Autoritetet kompetente komunikojnë nëpërmjet ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore apo sistemeve, të dokumentuar në zbatim të qëllimit të veprimtarisë së tyre.

2. Në rastet kur një informacion rreth subjektit të të dhënave personale rezulton i pasaktë ose duhet të fshihet në zbatim të pikës 6 dhe 7 të nenit 57 të ligjit, Kontrolluesi duhet ta komunikojë këtë informacion te çdo marrës i këtyre të dhënave, në mënyrë që të korrigjohen apo fshihen në çdo bazë të dhënash apo sistem që janë regjistruar, për këtë qëllim të përpunimit.

3. Të gjitha autoritetet kompetente që bashkëpunojnë duhet të garantojnë që përpunimi i të dhënave dhe përhapja e tyre, në zbatim të ligjit, të kryhet në mënyrë konfidenciale dhe të realizohet vetëm nga punonjës të autorizuar.

4. Përpunimi i të dhënave kryhet vetëm në masën e domosdoshme për përmbushjen e qëllimit pa e tejkaluar këtë të fundit.

5. Të dhënat sensitive përpunohen vetëm në rastet e parashikuara në nenin 52 të ligjit.

6. Përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave apo sistemeve, autoritetet kompetente duhet të garantojnë gjurmueshmërinë lidhur me veprimet e kryera ndaj të dhënave personale të përpunuara, sipas nenit 62 të ligjit.

Neni 8

Të drejtat e subjekteve të të dhënave personale

1. Autoriteti kompetent, ka detyrimin t'i sigurojë subjektit të të dhënave ushtrimin e të drejtave të tij në zbatim të neneve 55, 56 dhe 57 të ligjit, duke i ofruar informacionin në një formë koncize, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme⁵.

2. Kur subjektit të të dhënave nuk mund t'i ofrohet akses në të dhënat e tij personale për shkak të pengesave ligjore për rastin, kërkesa e këtij të fundit mund të vonohet, kufizohet apo refuzohet në atë masë dhe për aq sa është proporcionale, me qëllim shmangien e pengesave⁶ ose mbrojtjen e sigurisë kombëtare.

3. Në çdo rast, autoritetet kompetente duhet të dokumentojnë faktet dhe arsyet ligjore të refuzimit të së drejtës për akses, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Subjektet e të dhënave kanë të drejtë të kërkojnë pranë Komisionerit, rishikimin e përgjigjes së dhënë nga ana e autoriteteve kompetente, lidhur me kërkesën e tyre dhe ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale.

Neni 9

Transferimi i të dhënave personale

1. Transferimet e të dhënave personale nga ana e autoriteteve kompetente, do të kryhen vetëm në zbatim të neneve 70–74 të ligjit.

2. Në rastin e transferimit të të dhënave personale në mungesë të një vendimi përshtatshmërie, autoritetet kompetente duhet të informojnë Komisionerin, për kategoritë e transferimeve që janë kryer sipas pikës 2, të nenit 72 të ligjit.

⁵ Parashikuar në pikën 1, të nenit 54 të ligjit.

⁶ Kur kjo pengon kërkimet, hetimet, procedurat e zhvilluara nga autoritetet kompetente ose procesin gjyqësor.

Neni 10

Masat e sigurisë

1. Autoritetet kompetente duhet të marrin masa për arritjen e objektivave specifike të sigurisë, duke kryer vlerësimin e ndikimit në mbrojtjen e të dhënave, kur aktivitetet e përpunimit të të dhënave kanë të ngjarë të rezultojë në një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave. Ky vlerësim i ndikimit përfshin, si identifikimin e rreziqeve edhe përcaktimin e masave që duhen ndërmarrë për zbutjen e tyre⁷.

2. Në rastin e përdorimit të sistemeve apo pajisjeve të ndryshme teknologjike, autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin masa për mbrojtjen e të dhënave në projektim dhe në mënyrë të paracaktuar. Mbrojtja e të dhënave personale gjatë proceseve të përpunimit do të respektohet më mirë kur ajo është e integruar në teknologji që në momentin që ajo krijohet. Për rrjedhojë, duhet të ndërmerren masat teknike dhe organizative që në kohën e planifikimit të një sistemi përpunimi, për të mbrojtur sigurinë e këtyre të dhënave.

3. Në zbatim të nenit 61 të ligjit, autoritetet kompetente duhet të kryejnë dokumentimin e veprimtarive të përpunimit, në të cilin përmbahen edhe informacionet rreth përdorimit të profilizimit.

4. Autoritetet kompetente duhet të garantojnë nivelin e sigurisë së të dhënave duke përfshirë planet e sigurisë, përditësimin e sistemeve të TI dhe masave organizative, kryerjen e vlerësimit të ndikimit (veçanërisht kur përdoret një teknologji e re) dhe regjistrimin⁸ e veprimeve të veçanta të përpunimit.

5. Autoritetet kompetente, si kontrollues, në rast cenimi të të dhënave duhet të njoftojnë Komisionerin, si dhe subjektin e të dhënave.

6. Të gjithë punonjësit e autoriteteve kompetente, që i nënshtrohen këtij udhëzimi, janë të detyruar të mbajnë konfidencialë të dhënat e përpunuara gjatë ushtrimit të funksionit edhe pas përfundimit të tij.

7. Përpunimi i të dhënave sensitive dhe veçanërisht atyre biometrike dhe gjenetike kërkon masa të posaçme mbrojtje dhe kontrolli të dyfishtë, përfshirë administrim të ndarë dhe të mbrojtur fizikisht apo në sisteme të dedikuara.

Neni 11

Mekanizmat konfidencialë të raportimit

1. Autoritetet kompetente krijojnë dhe përdorin mekanizma apo kanale të sigurta dhe konfidencialë, që garantojnë raportimin e shkeljeve të ligjit⁹.

2. Mekanizmat e raportimit që garantojnë konfidencialitetin nga autoritetet kompetente, janë:

- a) e-mail i dedikuar me qasje të kufizuar;
- b) platformë *online* për përdorim të brendshëm, sipas aksesit të autorizuar;
- c) kuti/pajisje fizike të dedikuara të raportimit, të vendosura në ambientet e institucionit;
- d) raportim verbal me mbajtje protokolli në zyrë të caktuar.
- e) çdo formë tjetër raportimi që përmbush kërkesat e ligjit.

3. Në çdo rast të raportimit, autoritetet kompetente janë të detyruara të garantojnë konfidencialitetin e identitetit të raportuesit dhe personave të përfshirë.

⁷ Vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave parashikohet në nenin 64 të ligjit.

⁸ Detyrimi për regjistrim, parashikohet në nenin 62 të ligjit.

⁹ Shembull: Një punonjës policie konstaton se informacionet mbi të ndaluarit ruben në platforma jo të sigurta ose shpërndahen në *WhatsApp*, në grupe, në mënyrë të paautorizuar. Punonjësi mund të raportojë këtë shkelje si përpunim i paligjshëm i të dhënave personale, përmes një mekanizmi të brendshëm, si kutia fizike e raportimit, portali online ose një email-i të dedikuar.

4. Çdo autoritet kompetent duhet të miratojë procedura të brendshme të qarta për trajtimin e raportimeve, si dhe afatet për ruajtjen dhe asgjësimin e tyre, me qëllim dokumentimin dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore, sipas nenit 69 të ligjit.

Neni 12

Ruajtja dhe fshirja e të dhënave

1. Autoritetet kompetente duhet të parashikojnë në kuadrin e tyre rregullator afate të përshtatshme kohore për fshirjen e të dhënave personale, afate të rishikimit periodik të ruajtjes së tyre, si dhe të ndërmarrin masa konkrete për respektimin e këtyre afateve¹⁰.

2. Të dhënat personale duhet të ruhen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për aq kohë sa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit/eve për të cilin/at ato përpunohen. Prandaj, të dhënat personale duhet të fshihen ose të anonimizohen, në atë moment që nuk do të jenë më të nevojshme për qëllimin/et për të cilin/at, ato janë mbledhur në mënyrë të ligjshme nga autoritetet kompetente¹¹.

3. Të dhënat personale, kur përpunohen vetëm për qëllime arkivimi në interes publik, për qëllime kërkimore shkencore ose historike apo për qëllime statistikore, mund të ruhen për një periudhë më të gjatë sesa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit për të cilin janë grumbulluar. Kjo është e kushtëzuar me zbatimin e masave të duhura teknike dhe organizative, siç janë, në veçanti, pseudonimizimi ose anonimizimi, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave në përputhje me *“parimin e kufizimit të ruajtjes në kohë”*¹².

4. Autoritetet kompetente duhet të respektojnë në përputhje me fushën e tyre të kompetencës, të gjitha veprimtaritë e përpunimit të të dhënave personale duke siguruar që të dhënat të jenë të sakta dhe që periudhat e ruajtjes së të dhënave të respektohen. Të dhënat personale duhet të përditësohen kur ato nuk janë më të sakta, si dhe të fshihen nga baza e të dhënave kur ato nuk janë më të nevojshme për qëllimin e mbledhjes së tyre¹³.

5. Kur të dhënat personale janë korrigjuar ose fshirë, autoriteti kompetent duhet të njoftojë të gjithë marrësit e të dhënave personale përkatëse¹⁴.

Neni 13

Kriteret për rishikimin e nevojës për vazhdimin e ruajtjes së të dhënave

Në përcaktimin e nevojës për vazhdimin e ruajtjes së të dhënave personale, duhet të merren parasysh kriteret e mëposhtme:

a) mosha e subjektit të të dhënave, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë të miturve dhe personave të moshuar;

b) dënimet e shlyera, në rastin kur një person ka përfunduar dënimin e tij/saj me heqje lirie dhe ndërkohë periudha e parë e rishikimit ka kaluar, të dhënat e tij/saj personale duhet të fshihen, përveç rasteve kur ka prova se të dhënat janë të nevojshme për hetime të tjera në vazhdim. Në rastin e të dhënave sensitive, ato duhet të fshihen, përveç rasteve kur është e domosdoshme që ato të ruhen për shkak të hetimeve të tjera në vazhdim;

c) vendimet gjyqësore, veçanërisht vendimet për pafajësi që lidhen me vepra të caktuara penale, ku i gjithë informacioni mbi çështjet duhet të fshihet, përveç rasteve kur ka prova se të dhënat janë të nevojshme për hetime të tjera në vazhdim. Në rastin e përpunimit të të dhënave

¹⁰ Masat për respektimin e afateve mund të kryhen automatikisht nëpërmjet sistemit (*mbrojtja e të dhënave në projektim dhe në mënyrë të paracaktuar - privacy by design*) ose manualisht duke caktuar një person përgjegjës.

¹¹ Sipas nenit 57 të ligjit.

¹² Parashikuar në pikën 5, të nenit 6 të ligjit, si dhe nenin 45 të ligjit.

¹³ Në zbatim të nenit 6 dhe 57 të ligjit.

¹⁴ Detyrim që citohet në pikën 7 të nenit 57 të ligjit.

sensitive, ato duhet të fshihen, me përjashtim të rasteve kur është e domosdoshme që ato të ruhen për shkak të hetimeve të tjera në vazhdim. Të njëjtat kritere mund të zbatohen në rastet e amnistisë ose rehabilitimit.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjitha autoritetet kompetente.
2. Udhëzimi nr. 17, datë 11.5.2012, “Mbi përcaktimin e kohës së mbajtjes së të dhënave personale që përpunohen në sistemet elektronike, nga organet e policisë së shtetit për qëllime parandalimi, hetimi, zbulimi dhe ndjekje të veprave penale”, shfuqizohet.
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi